



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KOMISIONI I PROKURIMEVE ME VLERE TE VOGEL

Nr. _____ Prot.

Ballsh, më 19.11.2024

PROCESVERBAL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i prokurimit:

“Shpenzime per aktivite te Keshillit Bashkiak”,(Blerje bileta transporti, ajror Tirane-Bolonja-Tirane dhe tokesor Bolonja- Faenza-Bolonja si edhe akomodim ne Hotel per aktivitetin e Keshillit Bashkiak).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, mbështetur në nenin 68/9 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285 datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , autoriteti/enti kontraktor Bashkia Mallakastër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

“Shpenzime per aktivite te Keshillit Bashkiak”, (Blerje bileta transporti, ajror Tirane-Bolonja-Tirane dhe tokesor Bolonja- Faenza-Bolonja si edhe akomodim ne Hotel per aktivitetin e Keshillit Bashkiak).

Vlera e Fondit Limit: : Nuk aplikohet

Burimi i financimit: **nga buxheti i Bashkisë Mallakastër per vitin 2024.**

1. Specifikime teknike:

Nr.	Pershkrimi	Njësia	Sasia
1	Bileta avioni : Tirane-Bolonja (vajtje-ardhje)	Copë	22
2	Bileta treni : Bolonja (aeroport) deri ne Hotel (vajtje-ardhje)	Copë	22
3	Bileta treni : Bolonja –Faenza (vajtje-ardhje)	Copë	22
4	Akomodimi ne hotel ne Bolonja (2 netë)	Persona	22
5	Cicëron	Persona	1

1.Bileta avioni Tirane-Bolonja :

- Nisja nga Tirana per ne Bolonja ne daten 21 Nentor 2024.
- Kthimi nga Bolonja per ne Tirane ne daten 23 Nentor 2024.
- Klasi Ekonomik
- Bagazh dore 8-10 kg (çante dore/shpine) me permasa 40x30x20
- Operatori Ekonomik të realizoje check in online paraprakisht në vajtje dhe në kthim.

2.Bileta treni Bolonja (aeroport) deri ne Hotel :

- Nisja nga aeroporti Bolonjes pas mbërritjes date 21 Nentor 2024 deri ne Hotel.
- Kthimi nga vendqendrimi ne Hotel per ne aeroportin e Bolonjes date 23 Nentor 2024.

3.Bileta treni Bolonja-Faenza dhe Faenza-Bolonja,date 22 Nentor 2024.

- Nisje ne mengjes dhe kthimi pas dreke.

4.Akomodimi ne Hotel :

- Hyrje date 21 Nentor 2024
- Dalje date 23 Nentor 2024
- Hoteli te jete me 3 Yje, mengjesi i perfshire.
- 11 Dhoma te jene me kapacitet per 2 persona, me krevate te ndare per secilin person.

5.Ciceroni, i cili nuk perfshihet ne bilete dhe akomodim, me pagese extra.

Argumentimi:

Specifikimet teknike jane hartuar ne perputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, te ligjit nr.162/2020 "Per prokurimin publik" i ndryshuar , si dhe nenet 26, 41,44, 56 te VKM nr.285, date 19.05.2021, "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar.

6.Operatori ekonomik me ane te nje vetedeklarimi, duhet te marrë përsipër se:

- Do të angazhohet me përgjegjësi të lartë për zgjidhjen e problemeve lidhur me vonesat e fluturimeve, humbjen e bagazheve, sendeve të tjera si dhe çdo rast tjetër i paparashikueshëm.
- Të garantojë ruajtjen e konfidencialitetit, përsa i takon informacionit të siguruar nga Autoriteti Kontraktor.
- Të garantojë përballimin e çdo pasojë të mundshme ekonomike, në raste të jashtëzakonshme, si fatkeqësi natyrore, kushte të këqija të motit, grevë apo falimentim të operatorit, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fluturimit, orarit të biletës dhe të ditës së fluturimit, të cilat nuk vijnë si pasojë e veprimit të Autoritetit Kontraktor.
- Ne rast te mosparaqitjes se ndonje personi **do të rimbursojnë pjesën e humbur të udhëtimit dhe akomodimit.**
- Operatori ekonomik duhet të ushtroj aktivitet në fushën e shërbimit objekt prokurimi. Autoriteti kontraktor do të kryej verifikimet në QKB për objektin e veprimtarisë se operatorit ekonomik ,dhe në rast se operatori ekonomik nuk ka objekt aktiviteti per shërbimin që prokurohet ,operatori do të skualifikohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" , me anë të këtyre specifikimeve teknike kërkohet që Operatorët Ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetin e duhur për të realizuar shërbimin e kërkuar dhe për të përmbushur plotësisht shërbimin e kërkuar. Gjithashtu këto specifikime teknike janë të domosdoshme për zhvillimi e kësaj procedure prokurimi . si dhe udhëzimi (APP) nr. 4, datë 20.05.2022 "Disa shtesa në udhëzimin nr.3, datë 18.06.2021 "Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike".

7.Operatori ekonomik duhet të ushtroj aktivitet në fushën e shërbimit objekt prokurimi.

Autoriteti kontraktor do të kryej verifikimet në QKB për objektin e veprimtarisë se operatorit ekonomik ,dhe në rast se operatori ekonomik nuk ka objekt aktiviteti per shërbimin që prokurohet ,operatori do të skualifikohet.

2. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT :

1.Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) :

a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),

b) ka plotësuar detyrimet fiskale,

c) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore ,te lëshuar nga Administrata Tatimore.

2. Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këto kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë bazuar në nenet 76 dhe 77 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Të gjitha këto kritere janë të nevojshme që të vërtetojnë që operatori ekonomik fitues përmbush të gjitha detyrimet ligjore për ushtrimin e veprimtarisë dhe ka përgjegjësinë e seriozitetit për realizimin e objektivit të prokurimit.

Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për prokurimin publik dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

- Përcaktim i afateve

Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të paraqitet pranë autoritetit kontraktor **brenda 2 (DY) orëve** nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit, nga sistemi dinamik i biletave,si edhe duhet të dorëzoj :

Rezervimin e biletës së avionit, me të gjitha të dhënat, duke përfshirë klasin, sasinë, statusin dhe rezervimin e akomodimit në hotel.

Në të kundërt, do të bëhet kalimi të ofertuesit të radhës i kualifikuar në SPE, e kështu me radhë, deri në ofertuesin e fundit të mbetur në klasifikim.

- Në rast tërheqje nga oferta, operatori ekonomik duhet të njoftoj Autoritetin Kontraktor.
- Kriteri vlerësimit do të jetë çmimi më i ulët.

Nëse operatori ekonomik nuk përmbush karakteristikat/specifikimet teknike për shërbimin e kërkuar , kjo do të përbejë shkak për skualifikim të ofertuesit dhe kalim në ofertuesin pasardhës në renditje dhe Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për shpenzimet operative të operatorit ekonomik.

Ne ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhëna të plota të personit të kontaktit.

Në rast se nuk paraqitet duhet të njoftoj autoritetin kontraktor për arsyet e mos paraqitjes.

Mos njoftimi brenda afateve të përcaktuara më sipër i autoritetit kontraktor do të sjell skualifikim të operatorit ekonomik për këtë procedurë si dhe procedurat e tjera që do të zhvilloj autoriteti kontraktor.

Nëse itinerari sipas destinacionit të kërkuar dhe kushtet e akomodimit të ofruar nga OE janë në përputhje me kërkesat e AK, pas konfirmimit do të nis të dhënat e personave udhëtues në adresën elektronike (email) të Operatorit ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Udhëzimin nr.03 datë 18.06.2021 “Mbi Përdorimin e Sistemit Dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike” i ndryshuar.

Operatori ekonomik fitues në momentin e nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë:

- a) IBAN i tre muajve të fundit
- b) Kopje të Çertifikatës Elektronike të Fiskalizimit ,për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qëndrore të Faturave.
- c) Kopje të certifikatës elektronike për fiskalizimin dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen Software-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes Software-ike.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në ligjin nr.87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” i ndryshuar dhe njoftimit të përbashkët nr.25366.prot datë 30.12.2020 dhe nr.8480.prot datë 30.12.2020 të DPT-së dhe APP-së, ku shprehet se : prej datës 1 janar 2021 tatimpaguesit, të cilët kryejnë transaksione shitje me entet publike, kanë detyrimin ligjor të lëshojnë vetëm fatura elektronike për mallrat, punët apo shërbimet e shitura.

Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël :

Agetin Merkaj

Armela Malaj

Marjola Shehaj